

YLVI HANA

Auditues Ligjor/Praktikant i vetëm

Liçenca Nr.296, datë 27.08.2012

Adresa : Blv."Deshmoret e Kombit", Kulla Nr.1, Kati i 2, Tirane

email: ylvi_hana@yahoo.com

Mobil 069 20 69 054

RAPORT

TRANSPARENCE

VITI 2024

Përmbajtja

- 1) Hyrje**
- 2) Struktura Ligjore**
- 3) Kualifikimi Profesional**
- 4) Standartet Profesionale dhe Ligjet bazë të përditësuara**
- 5) Deklarata e politikës për kërkesat etike**
- 6) Metodologjia dhe qasja e auditit**
- 7) Qeverisja dhe udhëheqja**
- 8) Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë**
- 9) Kontrollet e kryera**
- 10) Shërbimet ndaj klientëve**
- 11) Tarifimi**
- 12) Kofidencialiteti**
- 13) Përputhshmëria rregullatore dhe profesionale**
- 14) Pozicioni Financiar**
- 15) Fushat kryesore të rrezikut dhe sfidat**
- 16) Konkluzion**

1. Hyrje

Ky raport transparence është lëshuar për të dhënë informacion mbi praktikat profesionale, kontrollat e brendshme dhe standardet etike të ndjekura nga Ylvi Hana Auditues Ligjor (AL) që drejton HANA AUDIT.

Jam praktikant i vetëm dhe pa staf të punësuar, përpiqem të mbaj standarde të larta integriteti, profesionalizmi dhe cilësie në ofrimin e shërbimeve të auditit.

2. Sruktura Ligjore

Ushtroj aktivitetin në Auditimin e PF si Auditues Ligjor i vetëm që nënkupton që nuk kam të punësuar punonjës profesionaliste.

- Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): **K81729010J**
- Emri i subjektit : Ylvi Hana
- Forma ligjore: Person Fizik
- Data e regjistrimit: 29/05/2008
- Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Njesia Administrative Nr.8, Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kulla Nr.1, Kati i 2, Z.Kadastrale 8270, Nr.Pasurie 3/239+1-N8, Tirane.
- Emri Tregtar: HANA AUDIT

Nuk bëjme pjesë në ndonjë rrjet të organizuar për Auditim ligjor të Pasqyrave Financiare individuale apo të konsoliduara.

3. Kualifikimi Profesional

- **Emri:** Ylvi Hana
- **Kualifikimi Profesional:** Auditues Ligjor
- **Anëtarësuar:** Anëtar në regjistrin Aktiv të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA)
- **Licensa:** Nr.296 dt.27.08.2012
- **Eksperienca:** 35 vite eksperiencë në menaxhim, kontabilitet, buxhetim, administrim, auditim, shërbime fiskale dhe misione të tjera të dhënies së sigurisë.

4. Standartet Profesionale dhe Ligjet bazë të përditësuara

Standartet

- SNA - Standardet ndërkombëtare të auditimit
- SNMC-Standardet Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë
- SNRF- Standardet ndërkombëtare të raportimit financiar
- SNK- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

- Kodi Ndërkombëtar i Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë)
- Kodi i Etikës- publikuar nga IEKA

Ligjet bazë-të përditësuar

- Ligji Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”
- Ligji Nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Legjislacioni ne fushen fiskale.

5. Deklarata e politikës për kërkesat etike

Partneri i vetëm i HANA AUDIT anagazhohet t'i përmbahet parimeve themelore të etikës profesionale siç përshkruhen në Kodi e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) dhe Kodin e Etikës të IEKA-s, duke mbajtur një standard të lartë të sjelljes personale për të shmangur çdo dëmtim të mundshëm të reputacionit të HANA AUDIT apo IEKA-s.

Interesi publik

Partneri i vetëm pranon përgjegjësinë e tij për të vepruar në interes të publikut.

Integriteti, objektiviteti dhe pavarësia

Partneri i vetëm nuk pranon angazhime nëse ka një lidhje me ndonjë klient, e tillë që do të cënonte pavarësinë e angazhimit.

Kur HANA AUDIT fillon të veprojë për një klient të ri Partneri i vetëm është i detyruar të konfirmojnë dhe shpalli pavarësinë e tij në lidhje me angazhimin para fillimit të auditimit ligjorë. Kjo deklaratë është e dokumentuar dhe e ruajtur në dosjen e angazhimit të auditimit të auditimit.

Partneri i vetëm është përgjegjës për vlerësimin e çdo kërcënimi ndaj pavarësisë dhe sigurimin se çdo kërcënim, që në mënyrë të qartë nuk është i parëndësishëm, të dokumentohet dhe eliminohet ose reduktohen në një nivel të pranueshëm.

6. Metodologjia dhe qasja e auditit

Si praktikant i vetëm, përdor standarde dhe metodologji të njohura që përputhen me standardet profesionale të auditimit. Kjo përfshin:

- **Metodë e bazuar në risk:** Vlerësoj dhe përqendrohemi në fushat që paraqesin rreziqet më të rëndësishme për pasqyrat financiare.
- **Kontrolli i Cilësisë:** Ndjek parimet e përshkruara në ISQC 1 (Standardi Ndërkombëtar mbi Kontrollin e Cilësisë) për t'u siguruar që auditimet e mia të përmbushin standardet më të larta të cilësisë.
- **Rishikimi i punës:** Ndërsa punoj vetëm, rishikoj periodikisht punën time të auditit dhe konsultohem me kolegët e profesionit për të siguruar objektivitet dhe cilësi dhe sipas kritereve që kam përcaktuar në Manualin e Menaxhimit Cilësisë të firmës kërkoj rishikim të cilësisë së angazhimit nga Auditues Ligjor të tjerë.

7. Qeverisja dhe udhëheqja

Pavarësia dhe objektiviteti janë gurët e themelit të punës sime si auditor. Praktikant e mëposhtme janë në fuqi për të mbajtur këto parime:

- **Pavarësia:** Unë marr të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar pavarësinë time në kryerjen e çdo angazhimi auditit. Kjo përfshin vlerësimin e konflikteve të mundshme të interesit dhe marrjen e hapave të duhur për t'i zbutur ato.
- **Qeverisja:** Si praktikant i vetëm, ndjek një proces vetë-monitorimi dhe shqyrtimi të kolegëve për të siguruar respektimin e standardeve etike dhe kërkesave rregullore.
- **Respektimi i standardeve etike:** I përmbahem Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të përcaktuar nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (BNSEK) dhe kornizave të tjera etike përkatëse.

8. Kontrolli dhe siguri i cilësisë

Për të siguruar cilësinë e lartë të auditimeve që kryej kemi hartuar një sistem të kontrollit të cilësisë që e pais atë me siguri dhe arsyeshmëri se Firma vepron në pajtim me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullore me qëllim që Raportet e leshuara nga firma janë të pershtatshme për rrethanat.

Sistemi i kontrollit të cilësisë të firmës përbehet nga politika të hartuara për të arritur objektivat e sistemit dhe nga procedura të nevojshme për zbatimin dhe monitorimin në përputhje me këtë politikë.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë: Unë kam përpiluar një Manual të Menaxhimit të Cilësisë për Studion dhe mbaj një sistem të kontrollit të cilësisë për çdo auditim, duke siguruar respektimin e standardeve dhe rregulloreve profesionale.

Shqyrtimi i performancës së angazhimit: Çdo angazhim auditimi i nënshtrohet proceseve të rishikimit të brendshëm, duke përfshirë një listë kontrolli të procedurave të auditit, vlerësimet e rrezikut dhe validimin e përfundimeve.

Konsultimi: Meqenëse jam një praktikant i vetëm, angazhohem në konsultime të rregullta me kolegë me eksperiencë në profesion për të kërkuar këshilla dhe qëndrime alternative mbi çështje komplekse ose të pazakonta.

9. Kontrollët e kryera

Kam filluar aktivitetet në auditimin me marrjen e titullit Auditues Ligjor dhe gjatë kësaj periudhe jame kontrolluar si nga Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), po edhe nga Bordi i Mbikqyrjes Publike.

- Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), ka ushtruar kontroll dy here. Kontrolli I parë është kryer në datën 25.10.2014 dhe kontrolli I dytë është kryer në datën 26.11.2016.
 - Bordi i Mbikqyrjes Publike ka ushtruar kontroll në datën 15.05.2020, i cili na ka ndihmuar për një përmirësim të metejshëm të cilësisë.
-

10. Shërbimet ndaj klientëve

- **Llojet e shërbimeve:** Unë ofroj shërbimet e mëposhtme:
 - Auditim Ligjor
 - Rishikim kontroll cilësie.
 - Mbajtje kontabiliteti dhe Përpilim të Pasqyrave Financiare
 - Konsulencë për kontabilitet dhe çështje fiskale
 - Misione të tjera të dhënies së sigurisë
 - Planë Biznesi
 - Analiza financiare
 - **Marëdhënia me klientët:** Mbaj komunikim transparent dhe të hapur me të gjithë klientët. Letrat e qarta të angazhimit lëshohen në fillim të çdo angazhimi, duke përshkruar fushëveprimin, tarifat dhe pritjet për të dyja palët. Motoja ime është ‘**puno për të shërbyer**’
-

11. Tarifimi

- Struktura ime e tarifës bazohet në kompleksitetin dhe madhësinë e angazhimit, dhe përcaktohet në mënyrë të drejtë dhe transparente. Ajo është rënë dakord me klientët në fillim të çdo angazhimi, me kushte të qarta të përcaktuara në letrën e angazhimit.
-

12. Kofidencialiteti

Ruaj konfidencialitetin e rreptë në lidhje me të gjitha informacionet e klientit dhe i përmbahem ligjeve dhe rregullave përkatëse në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë. Të gjitha regjistrimet e klientëve ruhen në mënyrë të sigurtë dhe aksesimi është i kufizuar.

13. Përputhshmëria rregullatore dhe profesionale

- **Respektimi i standardeve të auditimit:** Të gjitha angazhimet e auditit kryhen në përputhje me Standardet Ndërkombëtare mbi Auditimin (ISA).
- **Formimi i vijueshëm profesional :** Angazhohem në trajnime të rregullta dhe zhvillim profesional për t'u siguruar që jam i përditësuar me ndryshimet më të fundit rregullatore, standardet e auditimit dhe praktikat më të mira të industrisë. Plotësoj çdo vit 80 orë trajnim të detyrueshëm sipas kërkesave të organizatës profesionale ku bëj pjesë IEKA.

14. Pozicioni Financiar

Si praktikant i vetëm, unë zhvilloj një aktivitet të vogël dhe nuk kam të njëjtat raportime financiare, të cilat firmat më të mëdha janë të detyruara të japin. Megjithatë, jam i vendosur të mbaj praktikë të shëndosha financiare dhe operationale. Të Një përmbledhje e operationeve të mia të biznesit është si më poshtë:

- **Qarkullimi për vitin 2024:** 3.5 milion lekë
- **Fitimi Neto për vitin 2024:** 3.1 milion lekë

Qarkullimi sipas llojit të Shërbimit:

Lloji shërbimit	ne 000 leke
Auditim Ligjor të njësive ekonomike me interes publik (NIP)	419
Auditim Ligjor të njësive ekonomike me jo interes publik (Jo-NIP)	2,091
Sherbime të tjera të dhenies së sigurisë, kontabiliteti, konsulence dhe të tjera.	1,005
Total në mijë lekë	3,515

Lista e njësive ekonomike me interes publik, për të cilat është kryer auditimi ligjor gjatë vitit 2024:

-ZICO SHA.

- BECKER ALBANIA

Këto angazhime kanë qenë të përbashkëta me Auditues Ligjor të tjerë dhe tarifimi është në 1/2.

15. Fushat kryesore të rrezikut dhe sfidat

Si një firmë e vogël, dhe duke qenë i punësuar i vetëm, përballem me disa sfida unike, disa prej të cilave janë:

- **Menaxhimi i mbingarkesës:** Për shkak të madhësisë së firmës, marr përsipër një numër të kufizuar klientësh për të siguruar cilësinë dhe për të ruajtur ekuilibrin punë-jetë.
- **Ndryshimet e standarteve dhe ligjeve:** Respektimi i ndryshimeve të shpeshta në standardet dhe legjislacion është një sfidë e vazhdueshme. E trajtoj këtë nëpërmjet Formimit të Vijuëshëm Profesional-së dhe shkëmbimit me kolegët.

16. Konkluzion

Ky raport ka për qëllim të ofrojë transparencë dhe të demonstrojë angazhimin tim për ruajtjen e standardeve të larta profesionale në fushën e auditimit. Përpiqem vazhdimisht të përmirësoj cilësinë e punës sime, të siguroj respektimin e standardeve etike dhe profesionale dhe të mbaj një marrëdhënie të hapur dhe bashkëpunuese me të gjithë klientët.

Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për detaje të mëtejshme, ju lutemi të ndjeheni të lirë të më kontaktoni.

YLVI HANA

Auditues Ligjor/Praktikant i vetëm

Liçenca Nr.296, datë 27.08.2012

Adresa : Blv."Deshmoret e Kombit", Kulla Nr.1, Kati i 2, Tirane

email: ylvi_hana@yahoo.com

Mobil 069 20 69 054